

BIMËT MJEKSORE DHE AROMATIKE TË MALIT TË NËMËRÇKËS

DHIMITËR PEÇI.¹, ARSEN PROKO.², ALFRED MULLAJ.¹

¹Universiteti i Tiranës, Qendra Kërkimore e Florës dhe Faunës

²Univeriteti Bujqësor, Fakulteti i Shkencave Pyjore

e-mail: dhimiter.peci@fshn.edu.al

Përmbledhje

Mali i Nëmërçkës, në jug të Shqipërisë, ka diversitet të lartë të bimëve mjeksore dhe aromatike, të cilat përdoren gjërësisht në mjekësinë tradicionale si dhe në industrinë farmaceutike. Studimi siguron informacion mbi diversitetin, shpërndarjen, statusin sipas IUCN-së dhe përdorimet kryesore të bimëve mjeksore të Malit të Nëmërçkës. Si rezultat i studimit janë identifikuar në total 48 specie bimësh mjeksore dhe aromatike të cilat i përkasin 32 familjeve. Familjet më dominante janë ajo *Labiatae*, *Compositae*, *Rosacea* dhe *Leguminosae*. Mbi shfrytëzimi i bimëve dhe degradimi i habitateve natyrore janë faktorët kryesorë të zvogëlimit të popullatave të këtyre specieve me interes ekonomik. Sipas IUCN bimët janë kategorizuar si të rralla dhe të rrezikuara (13%) dhe vulnerabël (8%). Pjesa më e madhe e specieve të kategorisë në rrezik zhdukje u gjenden në zonat alpine dhe subalpine, duke sygjerruar potencialin e lartë të tyre si burim të bimëve mjeksore dhe aromatike por edhe për aplikimin e plan-strategjive të ruajtjes së habitateve natyrore të këtyre specieve.

Fjalëkyçe: Bimë mjeksore, diversitet, kategoritë IUCN, Nëmërçkë.

Abstract

Nëmërçka mountain, located in Southern Albania is characterized by high diversity of medicinal and aromatic plants, which are widely used in conventional medicine and pharmaceutical industries. This paper provides comprehensive information on the diversity, distribution pattern, status according to the IUCN categories, and the main uses of medicinal and aromatic plants in Nëmërçka Mountain. In this study a total of 48 medicinal and aromatic plants are identified belonging to 32 families. *Labiatae*, *Compositae*, *Rosacea* and *Leguminosae* are the most dominant families found. Plant overexploitation and degradation of natural habitats are the main causes of population decline of these species of high economical importance. Based on IUCN criteria, species were categorized as rare and endangered (13%) and vulnerable (8%). The majority of these species critically endangered were found in alpine and subalpine zones, identifying these zones as having high potential for supplying medicinal and aromatic plants and also for the application of conservation methods and strategies of these species and their natural habitats.

Key words: Medicinal plant, diversity, IUCN categories, Nëmërçkë.

Hyrje

Shqipëria është një vend me florë të pasur, favorizuar kjo nga vetë pozicioni gjeografik, format e relievit, klima e favorshme si dhe tipet e tokave. Kjo pasuri evidentohet edhe në faktin që rreth 47% e specieve Ballkanike dhe 30% e specieve Europiane rriten në Shqipëri (Vangjeli *et al.*, 1995).

Shqipëria ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm bimësh mjeksore dhe aromatike, të cilat përfaqësohen nga 310 specie që i përkasin 62 familjeve (Papathopulli, 1976).

Drurët, shkurret dhe bimët barishtore, organet e të cilave (rrënjët, gjethet, lëvorja, frutat, farërat, kërcelli, rizomat, etj) përmbajnë komponentë kurative për lloje të ndryshme sëmundjesh si dhe substanca aromatike konsiderohen bimë mjeksore dhe aromatike (Seci *et al.*, 2008). Përdorimi i bimëve mjeksore dhe aromatike në fushën e mjekësisë, farmakologjisë dhe kozmetikës përbën edhe një potencial të lartë ekonomik për vendet të cilat janë të pasura me këto bimë. Larmia e kësaj kategorie bimësh të ndodhura në Shqipëri e cila është më e lartë krahasuar me vendet e rajonit të bën Shqipërinë vend me potencial të lartë ekonomik në këtë drejtim (Kathe *et al.*, 2000).

Në përgjithësi bimët mjeksore rriten në lartësi të mëdha mbi nivelin e detit. Pjesa më e madhe e popullsisë që jeton në këto zona janë të angazhuar në mbledhjen e bimëve mjeksore dhe aromatike si të vetmin burim jetese për ta. Ky aktivitet intensiv antropogjen ka ardhur në rritje duke sjellë mbishfrytëzimin dhe dëmtimin e këtyre bimëve, ku pjesa më e madhe e tyre tashmë janë të përfshira në Librin e Kuq si bimë të rrezikuara dhe në rrezik zhdukje (Pazari, 2014). Kërkesa për bimë mjeksore është rritur ndjeshëm, kjo ka sjellë edhe mbi shfrytëzimin e habitateve natyrore dhe degradimin e tyre sidomos në zonat e pambrojtura sikurse është edhe Mali i Nëmërçkës i marrë në studim. Qëllimi i studimit është identifikimi i bimëve mjeksore të rritura në habitatet e tyre natyrore në Malin e Nëmërçkës si dhe vlerësimi i statusit të tyre. Inventarizimi dhe monitorimi i bimëve mjeksore aromatike në këtë zonë do të siguronte informacion shtesë mbi gjendjen e habitateve si dhe vlerësimin e shndërrimit potencial të këtyre zonave për ruajtjen in-situ të këtyre resurseve.

Materiali dhe metodat

Bimët mjeksore dhe aromatike janë mbledhur dhe përcaktuar si pjesë e studimit të florës dhe vegjetacionit të vargmalit Trebeshinë-Dhëmbel-Nëmërçkë. Zona e studiuar bën pjesë në Krahinën Malore Jugore dhe është pjesë e dy vargmaleve paralele me njëri-tjetrin: Trebeshinë-Dhëmbel-Nëmërçkë dhe Shëndëlli-Lunxhëri-Bureto. Nga pikëpamja gjeologjike përbëhet nga shkëmbinj gëlqerorë, dallohet për diversitet të lartë të ekosistemeve dhe habitateve, ekosisteme lumore, shkorrëte mesdhetare, pyje gjethegjerë, halorë dhe të përzier si dhe livadhe e kullota.

Ky mal ndodhet në pjesën Jug-Perëndimore të Rrethit të Përmetit, ka koordinata N 40° 08' 00'' E 20° 24' 00'', dhe një shtrirje altitudinale që varion nga 292m (Bredhi i Petranit) deri 2486m mbi nivelin e detit (Maja e Dritës). Ekspedita për inventarizimin e bimëve janë zhvilluar në periudhën Prill- Tetor 2011-2015. Speciet e mbledhura u identifikuan dhe emërtuan

duke përdorur “Udhëheqësi Fushor i Florës së Shqipërisë” (Vangjeli, 2003), më pas materiali bimor u herbarizua dhe depozitua në Herbarin Kombëtar.

Rezultatet dhe diskutime

Nga studimi rezulton se Mali i Nëmërçkës është i pasur me bimë mjeksore dhe aromatike. Në figurën 1 është paraqitur harta e përhapjes së këtyre bimëve në zonën e studimit. Lista e bimëve si dhe përdorimet kryesore të tyre paraqiten në tabelën 1. Numri më i madh i bimëve mjekësore dhe aromatike të rrezikuara për zhdukje u gjenden në zonën subalpine dhe alpine, kjo sygjeron potencialin e lartë të këtyre zonave si burim të bimëve mjekësore si dhe përfshirjen e tyre në plan-strategjitë e ruajtjes së këtyre resurseve.




Figura 1. Harta e vendndodhjes së bimëve mjeksore aromatike në Malin e Nëmërçkës

Janë gjetur dhe identifikuar në total 48 specie bimësh mjekësore dhe aromatike të cilat i përkasin 32 familjeve. Familjet më dominante janë *Labiatae* dhe *Compositae* me 18.7 % dhe 12.5 % të specieve të gjetura, respektivisht, familja *Rosacea* me 6.25%, *Leguminosae* me 4.16%, ndërsa 28 familjet e tjera përfaqësohen me rreth 2.1 % të specieve (Figura 2, Tabela 1)




Figura 2. Familjet e bimëve mjeksore dhe aromatike në Malin e Nëmërçkës

Speciet e gjendura në këtë studim përfaqësoheshin më së shumti nga bimë barishtore (35 specie) por edhe në forma të tjera drurë (2 specie) dhe shkurre (11 specie). Duke përdorur kriteret e IUCN (International Union for Conservation of Nature and Natural Resources, 2012), speciet aromatike mjeksore të gjendura në malin e Nëmërçkës u kategorizuan si të rrezikuara 13% e tyre (11% EN (A1b), 2% EN (A1c), vulnerable 8% (6% VU A1b, 2% VU A1c) ndërsa 79% specieve u kategorizuan si LC (Figura 3).




Figura 3. Kategoritë e bimëve mjeksore dhe aromatike sipas IUCN

Nga analiza e elementit korologjik (Figura 4), rezulton se bimët me origjinë mesdhetare zënë 21% të bimëve mjeksore aromatike. Kjo shpjegohet me faktin se klima mesdhetare ka një ndikim të fuqishëm me praninë e lumit

Vjosë gjatë gjithë shtrirjes së malit. Pas elementit mesdhetar vijnë elementët korologjik EuMed dhe EuAz përkatësisht me 15 dhe 14% të specieve.




Figura 4. Spektri korologjik të bimëve mjeksore aromatike të Malit të Nëmërçkës

Në zonën në studim janë të pranishme të katërt tipet e vegjetacionit. Bimët mjekësore që u gjenden në habitatet me dushkaja (*Quercus trojana*) ishin *Crataegus monogyna*, *Juniperus communis*, *Saturea montana*, *Ononis spinosa*, *Linum usitatissimum*, *Ceterach officinarum*. Në habitatet me makje u gjenden kryesisht llojet *Rosa canina*, *Thymus longicaulis*, *Viola odorata*, *Hedera helix*, *Bellis perennis*, *Teucrium chamaedrys*, *Pistacia terebinthus*, *Micromeria juliana*, *Arbutus unedo*, *Centaurium erythraea* etj. Në habitatin *Platanion orientalis* u gjenden llojet *Crataegus monogyna*, *Melissa officinalis*, *Origanum vulgare*, *Hedera helix*, *Rubus ulmifolius*, *Trifolium pratense*, *Vitex agnus-castus*, *Juglans regia*. Në habitatin me *Festuco-Brometea* u gjenden: *Origanum vulgare*, *Sideritis raeseri*, *Artemisia alba*, *Eryngium maritimum*. Në habitatet me Ah (*Fagus sylvatica*) të përzier (*Querco-Fagetea*) bimët mjeksore aromatike janë: *Clinopodium vulgare*, *Linum usitatissimum*, *Rumex acetosella*, *Taraxacum officinale*, *Stellaria media*, *Thymus longicaulis*, *Crataegus monogyna*. Në habitatet me *Quercus pubescens* bimët mjeksore që takohen janë: *Hypericum perforatum*, *Primula veris*, *Salvia officinalis*, *Viola odorata*, *Dictamnus albus*, *Teucrium chamaedrys*, *Clinopodium vulgare*.

Habitatet më të dëmtuara janë ato të makies dhe të dushqeve. Faktori kryesor për degradimin e tyre është faktori human dhe veprimtaria e tij. Shkaqet kryesore të prishjes së këtyre habitateve janë prerjet pa kriter, zjarret e qëllimshme dhe mbikullotja. Së fundmi një aktivitet akoma dhe më shkatërrues i këtyre habitateve është hapja e guroreve jo vetëm për mbledhjen e gurëve por edhe për inerte.

Nr	Emri Botanik	Kategoria IUCN	Përdorimi
1	<i>Colchicum autumnale</i>	EN (A1b)	Kundër reumatizmës
2	<i>Crataegus monogyna.</i>	LC	Antisklerotik, hipotonik
3	<i>Hypericum perforatum</i>	EN (A1b)	Trajtimin e ulçerave, sëmundjeve të mëlçisë
4	<i>Juniperus communis</i>	VU (A1b)	Në shërimin e hidropizisë, rregullime të aparatit urogenital dhe të frymëmarrjes
5	<i>Malva sylvestris</i>	LC	Në sëmundjet e aparatit tretës, dhe urinar
6	<i>Melissa officinalis.</i>	LC	Në uljen e presionit të ngritur të gjakut, kozmetikë
7	<i>Origanum vulgare</i>	EN (A1b)	Në inflamacionet e mukozave të gojës, si çaj
8	<i>Papaver rhoeas</i>	LC	Kundër ftohjes, kollës, pagjumësisë
9	<i>Primula veris</i>	LC	Trajtimin e të ftohurit, enfizemës së mushkërive
10	<i>Rosa canina</i>	LC	Trajtimin e skorbutit
11	<i>Salvia officinalis</i>	VU (A1b)	Në pakësimin e djersitjes, shton qumështin te nënat
12	<i>Saturea montana</i>	VU (A1c)	Për kurimin e sëmundjeve të lëkurës
13	<i>Thymus longicaulis</i>	LC	Në farmaceutikë, mjekësi e kozmetikë
14	<i>Urtica dioica</i>	LC	Diabet, reumatizëm, ekzemë
15	<i>Viola odorata</i>	LC	Trajtimin e kollës, mahisjes së cipave mukoze, në parfumeri.
16	<i>Hedera helix</i>	LC	Antiinflamator, kundër artritit
17	<i>Bellis perennis</i>	LC	Diuretik dhe antiseptik
18	<i>Capsella bursa-pastoris.</i>	LC	Trajtimin e hemoragjive, gurëve në rrugëve urinare
19	<i>Sideritis raeseri</i>	EN (A1c)	Antiinflamator, analgjezik, antimikrobial
20	<i>Centaurium erythraea</i>	LC	Trajtimin e anemisë, etheve, sëmundjeve të mëlçisë
21	<i>Ceterach officinarum</i>	LC	Si diuretik
22	<i>Clematis vitalba</i>	LC	Trajtimin e djegieve
23	<i>Dictamnus albus</i>	VU (A1b)	Diuretik, trajtimin e gurëve në veshka dhe hemorroideve.
24	<i>Ononis spinosa</i>	LC	Në pezmatimin e fshikzës urinare, në nefrite
25	<i>Paeonia officinalis</i>	LC	Trajtimin e kollës së mirë, epilepsisë, sëmundjeve nervore

Nr	Emri Botanik	Kategoria IUCN	Përdorimi
26	<i>Plantago lanceolata</i>	LC	Në katariet e mushkrive, trajtimin e hemorragjive
27	<i>Rubus ulmifolius</i>	LC	Si purgativ, mjekimin e skuqjes së grykës
28	<i>Stellaria media</i>	LC	Dobësisë së zemrës, sëmundjes së veshkave
29	<i>Taraxacum officinale</i>	LC	Trajtimin e sëmundjeve të mëlçisë, tëmthit, dhe fshikzës urinare
30	<i>Teucrium chamaedrys</i>	LC	Kundër kapsllëkut, në çrregullimet e stomakut
31	<i>Trifolium pratense</i>	LC	Dezinfektuese e lëkurës me ekzemë e me plagë
32	<i>Verbascum phlomoides</i>	LC	Në mjekimin e rrufës hemorroideve mëlçinë e zezë
33	<i>Vitex agnus-castus</i>	LC	Regullon ciklin menstrual, infertilitetin femëror.
34	<i>Arbutus unedo</i>	LC	Antiinflamator, antioksidant, antimikrobial, trajtimin e diabetit
35	<i>Pistacia terebinthus</i>	LC	Në infeksionet bronkiale, urinare
36	<i>Artemisia alba</i>	LC	Antiseptik, antibakterial
37	<i>Achillea millefolium</i>	LC	Pastrimin e rrugëve të frymëmarrjes
38	<i>Rumex acetosella</i>	LC	Çrregullime aparatit tretës dhe trajtimin e sinozitet
39	<i>Juglans regia</i>	EN (A1b)	Diabetin, azmën
40	<i>Morus nigra</i>	LC	Antikancer, trajtimin e diabetit
41	<i>Helichrysum stoechas</i>	EN (A1b)	Antibakterial
42	<i>Paliurus spina-christi</i>	LC	Antibakterial, antikolesterol
43	<i>Eryngium maritimum</i>	LC	Antioksidant, antiinflamator, antimikrobial
44	<i>Linum usitatissimum</i>	LC	Antikancer, ul kolesterolin, antiinflamator
45	<i>Micromeria juliana</i>	LC	Antioksidant, kozmetike
46	<i>Clinopodium vulgare</i>	LC	Antibakterial, antiinflamator
47	<i>Cirsium arvense</i>	LC	Antidiabetik
48	<i>Galium aparine</i>	LC	Hepatitet, cistet, problemet e tëmthit e veshkave

Tabela 1. Bimët mjekësore dhe aromatike në Malin e Nëmërçkës, kategorizimi sipas IUCN dhe përdorimet kryesore të tyre

Përfundime

Mali i Nëmërçkës rezultoi i pasur me bimë mjeksore dhe aromatike, ku gjatë studimit u evidentuan bimë të 32 , nga 62 familje të bimëve mjeksore dhe aromatike që rriten në shkallë vendi. Në dominancë u gjetën bimë të familjeve *Labiatae*, *Compositae*, *Rosacea* dhe *Leguminosae*. habitatet e këtyre bimëve ishin të dëmtuara ndërsa si pasojë e mbishfrytëzimit 13% e bimëve i përkisnin kategorisë të rrezikuara dhe 8% vulnerabël, sipas IUCN. Potenciali i lartë në bimë mjeksore dhe aromatike të zonës sygjeron nevojën për hartimin dhe aplikimin e strategjive të ruajtjes të kësaj pasurie llojore dhe habitateve të tyre.

Literatura

IUCN (2012): IUCN Red List Categories and Criteria. Version 3.1. Second Edition. ISBN 978-2-8317-1435-6

Kathe W., Honnef S., Heym A. (2000): Medicinal and Aromatic Plants in Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia and Romania, Federate Agency for Nature Conservation, TRAFFIC Europe, Bonn, Germany; 65

Papathopuli G. (1976): Bimët mjeksore dhe aromatike të Shqipërisë, Tiranë; 5

Pazari F. (2014): Vlerësimi ekonomik dhe ekologjik i bimëve mjeksore dhe aromatike të Shqipërisë në funksion të zhvillimit të ekonomisë rurale. Dizertacion; 115

Seci A., Toromani E., Çollaku N., Jorxhi F. (2008): Manual i bimëve mjeksore, tanifere dhe eterovajore, Tiranë; 10

Vangjeli J, Ruci B., Mullaj A. (1997): Libri i Kuq; 5

Vangjeli J. (2003): Udhëheqës Fushor i Florës së Shqipërisë. Akademia e Shkencave. ISBN 99927-818-6-6